



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. 499 Prot.

Patos, më 19/02 /2024

**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 17, datë 19/02 /2024

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË APARTAMENTIT NR. 1**  
**TË ISH KOPSHTIT ME KONTRATË HUAPËRDORJE PËR QYTETARIN Z.**  
**VIKTOR ABAZAJ**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, vendimit nr. 88 datë 25.11.2022 me nr. 2890/3 prot., datë 30.11.2022 të Këshillit të Bashkisë Patos “Për miratimin e masës së qirasë për banesat sociale për ish kopshtin në lagjen Mustafa Matohiti”, nenit 14, pika 2 dhe 3 të nenit 15, nenit 16, 34, 39 e 73 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, V.K.M. nr. 574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” si dhe V.K.M nr. 1093, datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparsive për dhënien e bonusit të strehimit”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopështit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.

**Anëtarët e Programit të Strehimit Social**

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
Shkëlqim Beqiraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 499/11 Prot.

Patos, më 19/02 /2024

RELACION  
PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË APARTAMENTIT NR. 1  
TË ISH KOPSHTIT ME KONTRATË HUAPËRDORJE PËR QYTETARIN Z.  
VIKTOR ABAZAJ

Të nderuar Këshilltar !

Bazuar në vendimin nr. 88 datë 25.11.2022 me nr. 2890/3 prot., datë 30.11.2022 të Këshillit të Bashkisë Patos "Për miratimin e masës së qirasë për banesat sociale për ish kopështin në lagjen Mustafa Matohiti" është vendosur që masa e qirasë për apartamentin 1 me sip. 73.2 m<sup>2</sup> në katin përdhe të godinës të ketë një vlerë vjetore qiraje 30,705 (tridhjetë mijë e shtatëqind e pesë) lekë, e plotëpjestuar me / 12 e barabartë me 2,558 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj. Bashkia Patos duke marr parasysh kërkesën për strehim të z. Viktor Abazaj si dhe kushtet sociale ekonomike ka vendosur që ky qytetar të strehoet në apartamentin nr. 1 të ish kopështit. Nisur dhe nga Raporti mbi vlerësimin e gjëndjes social ekonomike për familjen e z. Viktor Abazaj lëshuar nga sektori i shërbimit social ju bëjmë me dije se:

Familja e z. Viktor Abazaj është familje që përbëhet prej 4 anëtarësh, 2 bashkëshortët si dhe 2 fëmijët (djalë dhe vajzë). Që të dy fëmijët e familjes Abazaj vuajnë prej vitesh nga problemet e shëndetit mendor, sëmundje ndaj të cilës kanë përfitur kempin dhe masa e përfitimit për të dy fëmijët është 20,610 (njëzet mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë. Gjithashtu familja Abazaj trajtohet me ndihmë ekonomike në një vlerë prej 4,991 (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë në muaj. Në total familja Abazaj merr një vlerë mujore 25,601 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e një) lekë dhe klasifikohet në familje me të ardhura të ulta. Në këto kushtet që ndodhet kjo familje kërkojmë nga këshilli bashkiak miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopështit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.

**Anëtarët e Programit të Strehimit Social**

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj

6. Shkëlqim Bëqiraj

KRYETARI  
Faton Duro